



Sqarim mbi disa informacione të përhapura nga disa media

Marrë shkas nga informacioni spekulativ i përhapur në disa media elektronike që japin alarmin se niveli në HEC Fierzë ka arritur në kuota kritike, duke përbërë një kërcënim për sigurinë e digave, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sqaron se:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, e indinjuar për keqinterpretim të dhënash, për spekulim mediatik që gjeneron vecse panik dhe asnje të mirë publike, me përgjegjësi të plotë garanton të gjithë shtetasit shqiptarë dhe Organet e Pushtetit Qëndror dhe Vendor se menaxhimi i Kaskadës po realizohet sipas parashikimeve të Rregullores së Trajtimit të Plotave brenda kuotave të lejuara të operimit për periudhën në të cilën ndodhemi. Në asnjë rast nuk bëhet fjalë për arritjen e nivelit kritik, i cili nuk lidhet aspak me nivelin e operimit të lejuar të cilit i referohet burimi.

Korporata e ndjek në dinamikë situatën hidroenergjetike në kaskadën e Drinit dhe është në komunikim të vazhdueshëm me Instancat përkatëse që kanë përfaqësimin në Komisionin e Posaçëm të Trajtimit të Plotave.

Përfitojmë nga rasti t'u bëjmë thirrje mediave audiovizive mos përkrahin praktikën e përhapjes së informacioneve të pasakta që ngjallin panik dhe pasiguri në publik dhe nuk ndihmojnë Korporatën në punën e saj për menaxhimin me profesionalizëm të HEC-eve të Kaskadës mbi lumin Drin.